



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Datë 7.6.2023

Nr: 661

Ora: 11:30

VENDIM

PËR

**KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË VENDIMIN NR. 622, DATË 26.5.2023, TË  
KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE "PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET  
SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË RROGOZHINË, PËR ZGJEDHJET PËR  
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023"**

Sot më datë 7.6.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

**OBJEKT:** Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 622, datë 26.5.2023, "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pikat 1, shkronja "n", e 2, të ligjit 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, neni 112, i ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**VËREJ:**

Në seancën publike të datës 26.5.2023 mora në shqyrtim çështjen me objekt: "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023".

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, me vendimin nr. 622, datë 26.5.2023, vendosa:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Rrogozhinë, si më poshtë:

Data: 7.6.2023 Nr.661  
Ora: 11:30



"Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 622, datë 26.5.2023, "Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

<b>Subjekti Zgjedhor</b>	<b>Mandate</b>
Bashkë Fitojmë	4
Partia Socialiste e Shqipërisë	9
Partia Republikane Shqiptare	1
Partia Lëvizja e Legalitetit	1
Partia Socialdemokrate	2
Partia Demokratike	3
Mitat Kadri Daja	1

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Rrogozhinë, si më poshtë:

#### **Bashkë Fitojmë**

1	Hekuran	Selman	Xhani
2	Silvana	Hasan	Aliu
3	Indrit	Hamid	Dedej
4	Sadete	Asllan	Kaja

#### **Partia Socialiste e Shqipërisë**

1	Shpati	Çelik	Kolgega
2	Mukades	Xhaferr	Gixhari
3	Renato	Ibrahim	Kalemi
4	Fatmira	Sulejman	Thartori
5	Enver	Luan	Memolla
6	Alime	Ylli	Hoxha
7	Lulzim	Izet	Hasa
8	Gezime	Kadri	Met-hasani
9	Erind	Bardhyl	Tosku

#### **Partia Republikane Shqiptare**

1	Ferdi	Nexhip	Avdiu
---	-------	--------	-------

### **Partia Lëvizja e Legalitetit**

1	Sokol	Xhemal	Gosa
---	-------	--------	------

### **Partia Socialdemokrate**

1	Altin	Fiqiri	Tosku
2	Besnik	Izet	Kushi

### **Partia Demokratike**

1	Bajazit	Idriz	Thaçi
2	Besnike	Xhevdet	Coraj
3	Saimir	Hariz	Cani

### **Kandidat i propozuar nga zgjedhësit**

1. Mitat Kadri Daja

Partia Socialdemokrate, me shkresën me nr. 2143 prot., datë 25.5.2023, ka informuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për konstatimin e një pasaktësie në pikën 2 (dy) të vendimit të sipërcituar.

Konkretisht lista e kandidatëve të shpallur fitues nuk përputhet me listën e regjistruar nga subjekti zgjedhor në KZAZ-në, nr. 43 Bashkia Rrogozhinë, zj. Fatbardha Ndriçim Sina është e renditur e dyta në listën shumëmemërore të regjistruar në KZAZ dhe nuk rezulton të jetë e renditur ndër dy kandidatët fitues të shpallur nga KQZ me vendimin nr. 622, datë 26.5.2023.

Nga verifikimi i kryer rezulton se, në listën shumëmemërore të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Socialdemokrate”, zj. Fatbardha Ndriçim Sina është e renditur e dyta.

Në nenin 112, të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se “Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ”.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 112 i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

## V E N D O S:

1. Korrigjimin e gabimit material në pikën 2 të vendimit nr. 622, datë 26.5.2023, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në këtë mënyrë: Renditjen e zj. Fatbardha Ndrëçim Sina të dytën në listën e kandidatëve fitues të subjektit zgjedhor "Partia Socialdemokrate, në vend të z. Besnik Izet Kushi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

